

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 6202  
E hënë, 28 dhjetor 2020  
çmimi 0.40 €

## Sot pritet të votohet buxheti i Kosovës për vitin 2021



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PËRFAQËSUES TË PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK)  
MBAJNË KONFERENCË PËR MEDIA

## PDK-ja ME PAKO PËR DIASPORËN, TRI ULËSE NË KUVEND DHE RIKTHIMIN E MINISTRISË SË DIASPORËS



Kandidati i Partisë Demokratike i Kosovës (PDK) për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka paraqitur pakon qeverisëse të diasporës e cila përmban propozime konkrete: tri vende të rezervuara në listën për deputetë dhe rikthimin e Ministrisë së Diasporës. Hoxhaj ka thënë se në prag të këtyre zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, PDK-ja ka vizionin më të qartë dhe veprime konkrete për ta afruar edhe më shumë mërgatën me Kosovën

LËVIZJA VETËVENDOSJE KA MBAJTUR MBLEDHJEN E KËSHILLIT TË PËRGJITHSHËM

## KURTI THOTË SE VETËVENDOSJA DO TË KETË MË SHUMË SE 65 DEPUTETË

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të dielën se gjasat janë që në zgjedhjet e vitit të ardhshëm nga lista e tyre të dalin mbi 65 deputetë. Ai

ka theksuar se mbështetja për LV-në është rritur dyfish, ndërsa shprehi bindjen për një qeveri që udhëhiqet nga partia e tij. "Sa herë vendosin



pengesa të padrejta, që përpiqen ta ndalin LV-në, ajo vetëm rritet. Populli nuk i do hileqarët dhe i dënon ata", ka thënë Kurti

## SEIMI FTON ORGANET E DREJTËSISË T'I NISIN HETIMET PËR HYRJEN E VAKSINAVE ILEGALE NË VERI



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

### OPINION

#### KOSOVA NË MES TË OLIGARKISË DHE DEMOKRACISË SË BRENDSHME

F. 11

Nga Mehmet  
PRISHTINA



### AKTUALE



#### DERI MË TANI 1 309 TË VDEKUR NGA COVIDI NË KOSOVË

F. 6

#### PAQARTËSI RRETH POZITËS SË PRESIDENTIT

F. 7

### EKONOMI



#### DIASPORA NGA PASLUFTA KA DËRGUAR MBI 40 MILIARDË EURO NË KOSOVË

F. 9

#### EKONOMIA NË SHQIPËRI KA RËNË NË 5.3 PËR QIND

F. 9

### SPORT

#### BASHKIMI MUNDI PEJËN

F. 12





## Trumpi nuk e nënshkruan paketën e ndihmës ekonomike



WASHINGTON, 27 DHJETOR - Miliona amerikanë humbën përkohësisht përfitimet nga të qenët të papunë, pasi presidenti Donald Trump nuk e nënshkroi paketën për ndihmë. Kjo paketë, në vlerë prej 900 miliardë dollarësh, është miratuar nga Kongresi javën e kaluar, për t'i ndihmuar qytetarët që kanë mbetur pa punë si pasojë e pandemisë së Covid-19.

Shpërndarja e mjeteve të saj do të bëhej vetëm pasi të nënshkruhej në ligj nga presidenti. Presidenti i

zgjedhur i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, paralajmëroi për "pasoja shkatërruese" nëse Trumpi vazhdon ta shtyjë nënshkrimin, por afati i së shtunës tashmë ka kaluar. "Është një ditë pas Krishtlindjeve dhe miliona familje nuk e dinë nëse do të jenë në gjendje t'i përmbushin nevojat për shkak të refuzimit të presidentit Donald Trump për ta nënshkruar paketën e ndihmës ekonomike, të miratuar nga Kongresi, me shumicë dërrmuese dhe dypartiake", ka deklaruar

Biden.

Trumpi tha se dëshiron t'u japë njerëzve pagesa më të mëdha. Paketa aktuale parasheh 600 dollarë në muaj për amerikanët që fitojnë më pak se 75 000 dollarë në vit. Trumpi tha se dëshiron që amerikanët të marrin nga 2 000 dollarë në muaj, por republikanët në Kongres kanë refuzuar të pajtohen për këtë ndryshim. Në një postim në "Twitter", të shtunën vonë, Trump e mbrojti pozicionin e tij në këtë çështje dhe fajësoi Kinën për shpërthimin e Covidit.

## Rusia ndalon katër video të AP-së për luftën në Çeçeni

MOSKË, 27 DHJETOR - Një gjykatë në qytetin Nallçik të Rusisë ndaloi katër video arkivore të agjencisë së lajmeve Associated Press (AP).

Videot nga lufta e Çeçenisë e viteve 1990 dhe 2000 u cilësuan "propagandim i mizorisë". Njëra prej tyre tregon ushtarë rusë duke u mbajtur të burgosur nga luftëtarët çeçenë në vitin 1995. Në këtë video, e cila është shikuar rreth dy milionë herë, një oficer rus thotë se është trajtuar "shumë çuditërisht" dhe kritikon taktikat ruse në luftë. Një video tjetër, po ashtu e vitit 1995, tregon rezultatet e

sulmeve ruse në qytetet çeçene: Grozni, Argun dhe Shali.

Vendimi i gjykatës thotë se videot "lehtësojnë ndërmarrjen e veprimeve të paligjshme", mund të provokojnë "pasoja negative shoqërore, ekonomike dhe të tjera", si dhe shkelin "të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një shtet të bazuar në ligj, siç e garanton edhe Kushtetuta".

Rusia ka zhvilluar dy luftëra kundër separatistëve në Çeçeni. E para ka filluar në dhjetor të vitit 1994 dhe ka zgjatur deri në gusht të vitit 1996.

Ajo ka përfunduar me një

marrëveshje të paqes, që i ka dhënë Republikës së Çeçenisë një shkallë të konsiderueshme të autonomisë.

Lufta e dytë çeçene ka filluar në gusht të vitit 1999 dhe zyrtarisht ka marrë fund kur Rusia ka shpallur fundin e "operacionit kundër terrorizmit" në republikë, në prill të 2009-s. Konfliktet kanë shkaktuar dhjetëra mijëra viktima civile dhe qindra mijëra të zhvendosur. Ato janë kritikuar nga aktivistët vendës dhe ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut për shkelje të të drejtave dhe mizori nga të dyja palët.



## Incidenti në Nashvill mund të ketë qenë 'sulm vetëvrasës'



NASHVILL, 27 DHJETOR - Shpërthimi i një kamioni në Nashvill të SHBA-së, në Ditën e Krishtlindjeve, ka qenë me gjasë "sulm vetëvrasës", raportuan mediat amerikane duke cituar zyrtarë të zbatimit të ligjit. Hetuesit janë duke kryer teste të ADN-së, pasi mbetjet njerëzore janë gjetur afër vendit të shpërthimit të fuqishëm.

CNN citoi një zyrtar të FBI-së të ketë thënë se agjentët nuk janë duke kërkuar të dyshuar të

tjerë, pasi mbetjet njerëzore janë gjetur. CBS News tha se teoria kryesore tani është se subjekti mund të jetë vrarë në shpërthim.

Shtëpia e një personi të mundshëm me interes është kontrolluar të shtunën në periferi të qytetit Nashvill. Autoritetet nuk kanë pranuar ta identifikojnë personin në fjalë. Tre veta kanë mbetur të plagosur nga shpërthimi, ndërsa janë dëmtuar rëndë disa ndërtesa historike.

Motivi për shpërthimin nuk është përcaktuar ende.

Pasi vizitoi vendin e ngjarjes, Bill Lee, guvernator i shtetit Tenezi, ku ndodhet Nashvill, tha se "është mrekulli që askush nuk është vrarë". FBI është duke hetuar incidentin dhe kërkoi nga publiku informacione që mund të ndihmojnë.

Ndërkohë, bizneset dhe personalitetet televizive kanë ofruar më shumë se 300 000 dollarë për t'i kapur përgjegjësit.

## Dhjetë alpinistë të vdekur nga stuhia e borës në Iran



TEHERAN, 27 DHJETOR - Stuhitë e borës në Iran lanë së paku 10 alpinistë të vdekur dhe disa të zhdukur. Lajmi u bë me dije nga televizioni shtetëror, pas disa ditësh me

reshje me borë dhe erëra të fuqishme, që bllokuan rrugën në shumë pjesë të vendit. Sipas disa raporteve, numri i viktimave mund të jetë më i lartë, pasi disa

alpinistë që kanë qenë në male në veri të Teheranit mbeten të zhdukur. Kërkimet dhe përpjekjet e shpëtimit u ndërprejnë gjatë natës, por pritet të vazhdojnë

sot. Autoritetet e parashikimit të motit i kanë paralajmëruar më herët qytetarët që të mos udhëtojnë në male, ku janë raportuar stuhi dhe ortekë bore.



Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm

# Kurti thotë se Vetëvendosja do të ketë më shumë se 65 deputetë

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të dielën se gjasat janë se në zgjedhjet e vitit të ardhshëm nga lista e tyre do të dalin mbi 65 deputetë. Ai ka theksuar se mbështetja për LV-në është rritur dyfish, ndërsa u shpreh bindshëm për një qeveri që udhëhiqet nga partia e tij. “Sa herë vendosin pengesa të padrejta, që përpiqen ta ndalin LV-në, ajo vetëm rritet. Populli nuk i do hileqarët dhe i dënon ata”, ka thënë Kurti

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 DHJETOR - “Pas vendimit të fundit të Gjykatës Kushtetuese, zgjedhjet janë pranë, gjasat janë se nga lista jonë të bëhen deputetë më shumë se 65 emra”, ka thënë lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të kësaj partie. Ai ka pohuar se sa herë të mundohen ta ndalin Lëvizjen Vetëvendosje me hile ajo do të rritet. “Le të shërbejë ky si mësim, me intriga e me shërbime sekrete nuk ka përparim në politikë. Nuk i ha populli mashtrimet. Ky emancipim i popullit do të bëjë që Lëvizja Vetëvendosje t’i marrë 2/3 e votave”, ka thënë Kurti.

Ai ka theksuar se në qeverisje të vendit nuk do të punohet me hakmarrje, por me drejtësi. “Nuk është koha që të ikë një bandë e të vijë një klikë. Nuk është kohë hakmarrjesh. Është kohë drejtësie. Askush nuk do të largohet nga puna vetëm pse i përket një partie, askush nuk do të rrijë në një pozitë që nuk e meriton dhe askush nuk do të

lihet jashtë kur e meriton. Nuk do ta kapim shtetin, por ta çkapim”, ka thënë ai.

Kurti ka përmendur edhe Vjosa Osmanin në rastin kur ajo ishte vënë në krye të Kuvendit, duke e quajtur fat të mirë zëvendësimin nga ajo të Glauk Konjufcës. Fat i mirë, thotë Kurti, është se Osmani “nuk ishte servile, por ishte dinjitoze dhe i përket atij grupi të LDK-së që vendosi ta mbajë fjalën që ua dhanë votuesve”.

Por, pavarësisht prej kushteve e kërkesave që Kurti thotë iu bënë nga LDK-ja sa ishin në koalicion, LV-ja rritet. “Ne kishim fituar zgjedhjet më 6 tetor, por atyre (LDK) nuk u pëlqente rezultati. U dukej se kishin fituar me pak diferencë. Kështu që nisën të na vinin kusht pas kushti e kërkesë pas kërkesë. Nuk donin të pranonin se ndryshimi kishte filluar e qytetarët donin LV-në. Sa herë vendosin pengesa të padrejta, që përpiqen ta ndalin LV-në, ajo vetëm rritet. Populli nuk i do hileqarët dhe i dënon ata”, ka thënë Kurti, duke shtuar se mbështetja për LV-në është rritur dyfish, ndërsa u shpreh bindshëm për një qeveri që udhëhiqet nga partia e tij.



## Quni i gatshëm ta pranojë kandidaturën për kryeministër

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në Prizren, Anton Quni, nuk do ta refuzonte kandidaturën për kryeministër të Kosovës nëse subjekti i tij politik e

propozon për zgjedhjet e ardhshme parlamentare që pritet të mbahen së shpejti. “Gjithmonë jam i gatshëm për sfida të reja dhe asnjëherë nuk iki nga përgjegjësit”, ka deklaruar Quni.

Sipas tij, LDK-ja është e gatshme për zgjedhje. “LDK-ja ka struktura të konsoliduara mirë. Është parti serioze dhe e gatshme për ballafaqim me zgjedhje”, ka thënë Quni për “PrizrenPress”.

## Reshitaj kërkon paga për specialistët

PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Albena Reshitaj, e cila është edhe kryetare e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, u ka ofruar mbështetje specialistëve të drejtimit Mjekësi e Përgjithshme. Ajo në

llogarinë e vet në “Facebook” ka shkruar se janë mbi 300 specialistë nga drejtimi i Stomatologjisë që janë duke pritur që, pas kalimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, të kalojnë në paga. Ajo ka ftuar aktorët politikë në vend që t’i sistemojë specialistët në

paga sa më shpejt. “Si AAK gjithmonë kemi përkrahur dhe do të përkrahim kërkesa të tilla, andaj si kryetare e Komisionit Parlamentar për shëndetësi i ftoj të gjithë aktorët politikë që këta doktorë t’i sistemojë në paga sa më shpejt”, ka shkruar deputetja Reshitaj.







PËRFAQËSUES TË PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK)  
MBAJNË KONFERENCË PËR MEDIA

## PDK-ja ME PAKO PËR DIASPORËN, TRI ULËSE NË KUVEND DHE RIKTHIMIN E MINISTRISË SË DIASPORËS

Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Enver Hoxhaj, ka prezantuar pakon qeverisëse të diasporës e cila përmban propozime konkrete: tri vende të rezervuara në listën për deputetë dhe rikthimin e Ministrisë së Diasporës. Hoxhaj ka thënë se në prag të këtyre zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, PDK-ja ka vizionin më të qartë dhe me veprime konkrete për ta afruar edhe më shumë mërgatën me Kosovën

për herë të parë në listën e saj për deputetë 3 personalitete të fuqishme intelektuale, profesionale dhe në fushën e ndërmarrësisë që vijnë nga diaspora si dhe do ta rikthejë Ministrinë e Diasporës, ku edhe ministri do të jetë nga diaspora. Partia Demokratike zotohet se hapin e parë që do ta bëjë në qeveri do të jetë rikthimi i Ministrisë së Diasporës, e cila u shua nga qeveria LV-LDK, parti që u thirrën shumë në diasporën, dhe ministri do të jetë nga diaspora”, ka thënë Hoxhaj.

Ai ka theksuar se shteti i Kosovës duhet të bëjë më shumë për ta lehtësuar ardhjen e mërgimtarëve për festat e fundvitit në Kosovë. Hoxhaj ka thënë se diaspora është infuzioni i ekonomisë së Kosovës. “Ata janë mbështetësja jonë kryesore në kohë të vështira. Ata janë gazmendi i familjeve kosovare

në kohë të vështira. Para së gjithash, ata janë pjesë e kombit që sa më larg të jeni, më afër atdheut ndiheni. Mërgata këto ditë i jep infuzion ekonomisë së Kosovës dhe po e forcon edhe më shumë pakon për rimëkëmbje që u votua me mbështetjen e PDK-së. Edhe historia e Partisë Demokratike lidhet pashmangshmërisht me diasporën. Ne kemi qenë dhe do të jemi afër tyre. Prandaj, në prag të këtyre zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, ne kemi vizionin më të qartë dhe me veprime konkrete për ta afruar edhe më shumë mërgatën me Kosovën”, ka deklaruar Hoxhaj.

Ai ka thënë se me PDK-në në qeveri diaspora do të lirohet nga obligimet e sigurimit kufitar jo vetëm për një vit, por deri në anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Këshillin e Byrove së Kartonit të Gjellbër. “Si rrjedhojë,

kartoni i gjellbër i cilitdo shtet në botë do të vlejë edhe në Republikën e Kosovës. Si kryeministër i ardhshëm betohem se ky plan do të jetë qëllimi dhe vizioni im dhe i Partisë Demokratike të Kosovës për katër vjetet e ardhshëm”, është shprehur kryetari në detyrë i PDK-së, Enver Hoxhaj.

Ndërkaq deputeti, anëtari i kryesisë dhe udhëheqësi i Departamentit për Diasporë, Elmi Reçica, ka thënë se PDK-ja po rikthehet fuqimisht në diasporë. “Sot e kemi shpallur si ditë të diasporës me qëllimin që të jemi sa më afër tyre. Tash kemi nisur një riorganizim të jashtëzakonshëm dhe po kthehemi fuqishëm në diasporë. E kemi nisur me Zvicrën, tani do ta kemi themelimin e degës në Gjermani dhe së shpejti do të jemi në ShBA dhe Kanada”, ka thënë Reçica.

**EPOKA  
ERE**

**Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Enver Hoxhaj, në një konferencë për media të dielën ka prezantuar pakon qeverisëse të diasporës, e cila përmban propozime konkrete.

Në një konferencë për media, ai ka thënë se PDK-ja do të ketë në listën e saj tre kandidatë për deputetë që janë personalitete të veçanta në fushën e ndërmarrësisë dhe profesioneve të tjera. Po ashtu, ai ka propozuar rikthimin e Ministrisë së Diasporës me ta marrë qeverinë e ardhshme në udhëheqje. “Partia Demokratike do të inkuadrojë



## Gërxhaliu: Pas Kizhevaku do të kontrollohet miniera e Shtavalit

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Drejtori i Institutit i Mjekësisë Ligjore në Kosovë, Arsim Gërxhaliu, ka paralajmëruar se së shpejti do të nisin gërmimet te miniera e Shtavalit në Serbi, ku dyshohet se ka trupa të personave të zhdukur nga lufta në Kosovë. “Në Serbi [gjatë vitit 2020] kemi kontrolluar tri lokacione, në mesin e të cilave është Kizhevaku si lokacioni i pestë i

gjetjes së mbetjeve mortore. Kemi qenë edhe në Kozarevë të Novi Pazarit si dhe kemi bërë kontrollin e Shtavalit, gjithashtu një minierë ku dyshohet se ka një varrezë, së cilës do t’i qasemi pas Kizhevaku”, tha Gërxhaliu në një konferencë për media, duke raportuar për punën e bërë gjatë këtij viti.

Varreza masive në Kizhevak

është e pesta me viktima shqiptare që është zbuluar në territorin e Serbisë. Deri më tash nga Kizhevaku janë nxjerrë mbetjet mortore të 4-5 personave. Gërxhaliu tha se kërkimet atje do të vazhdojnë edhe në vitin e ardhshëm, pasi të përmirësohen kushtet e motit. Ai, po ashtu, tha se gjatë vitit 2020 në Kosovë janë kontrolluar nëntë lokacione, ku

janë gjetur 11 trupa të personave të zhdukur.

Kryetari i Komisionit Qeveritar për Personat e Pagjetur, Ramë Manaj, tha se pandemia e koronavirusit e ka stagnuar punën e këtij komisioni. Ai tha se ka pritur nga Bashkimi Evropian që ta rrisë presionin ndaj Serbisë, për të dhënë informacione për të zhdukurit. Pas përfundimit të luftës në

Kosovë, në vitin 1999, rreth 6 500 persona kanë qenë të zhdukur.

Që nga ajo kohë janë kryer disa zhvarrime në varreza masive në Kosovë dhe Serbi dhe deri më tash janë gjetur rreth 70 për qind e të zhdukurve. Sipas autoriteteve në Kosovë, të pagjetur vazhdojnë të jenë edhe rreth 1 600 persona, kryesisht shqiptarë.



## Osmani kërkon mbështetjen ndërkombëtare për ndjekjen e krimeve serbe

PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER) - Ushtruesja e detyrës e presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka kërkuar mbështetjen e aleatëve ndërkombëtarë, për të ndjekur, siç tha, “kryesit e krimeve të luftës dhe të gjenocidit në Kosovë”.

Në mesazhin e fundvitit drejtuar aleatëve, Osmani tha se Kosova nuk mund t’i kapërcejë e vetme sfidat dhe se sukcesi i saj varet nga mbështetja e miqve dhe e aleatëve. “Gjatë gjithë historisë sonë, populli i Kosovës vazhdimisht ka demonstruar një dëshirë të madhe për paqe, stabilitet dhe drejtësi. Ndërsa paqja është arritur, lufta për të vërtetën ende vazhdon. Pas më shumë se dy dekadash, plagët e Kosovës nuk mund të shërohen pa drejtësi”, ka thënë Osmani në video-mesazhin e publikuar në



“Facebook”.

Osmani kujtoi gratë e dhunuara nga forcat serbe gjatë luftës dhe tha se asnjë person i vetëm nuk është ndjekur penalisht për këtë

“krim të neveritshëm”. “Ne ende sot kemi prindër që dëshirojnë të dinë vendndodhjen e mbi 1 600 kosovarëve të zhdukur. Ata jetojnë me shpresën se një ditë

do të gjejnë drejtësi. Ata kanë të drejtë të dinë vendndodhjen e më të dashurve të tyre të zhdukur”, tha Osmani. Si ushtruese e detyrës e

presidentit, Osmani tha se “kur historia dhe e vërteta sfidohen”, ajo ndien përgjegjësi që të sigurojë se për to “flitet me zë të lartë dhe të qartë”. “Nisur nga kjo, ne kërkojmë mbështetjen tuaj në ndjekjen tonë për drejtësi për krimet e luftës dhe gjenocidin serb, si dhe në kërkimin tonë për përgjegjësi për personat tanë të zhdukur”, ka thënë Osmani.

Ajo, po ashtu, i falënderoi aleatët ndërkombëtarë për mbështetjen e dhënë për Kosovën gjatë pandemisë së koronavirusit. Osmani, kryetare e Kuvendit të Kosovës, është bërë ushtruese e detyrës e presidentit në fillim të nëntorit, kur Hashim Thaçi ka dhënë dorëheqje për t’u përballur me akuzat për kime lufte, të ngritura nga Prokuroria Speciale në Hagë.



# Selimi fton organet e drejtësisë t'i nisin hetimet për hyrjen e vaksinave ilegale në veri

Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka ftuar kryeprokurorin e Shtetit dhe ushtruesin e detyrës së drejtorit të Policisë së Kosovës që t'i fillojnë hetimet për hyrjen e vaksinave ilegale në veri. Ndërkaq Qeveria e Kosovës në një komunikatë për media ka theksuar se në bazë të informatave të marra nga Dogana dhe nga Policia Kufitare, nuk ka të dhëna se në rrugë zyrtare në territorin e Kosovës kanë hyrë vaksinat kundër Covid-19



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 27 DHJETOR** - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, ka ftuar kryeprokurorin e Shtetit dhe ushtruesin e detyrës së drejtorit të Policisë së Kosovës, që t'i fillojnë hetimet për hyrjen e vaksinave ilegale në veri. "Përtej obligimit tonë që ta sigurojmë shëndetin e të gjithë qytetarëve tanë pa dallim etnie, Republika e Kosovës ka sistemin e prurjes së vaksinave përmes Ministrisë së Shëndetësisë dhe IKShP-së. Çdo vaksinë ose medikament që hyn jashtë këtij sistemi mund të jetë ilegal dhe ta cenojë sigurinë kombëtare të Republikës", ka thënë ministri. Ai ka theksuar se Kosova nuk ka ndarje të privilegjit se kush merr vaksinë më herët apo më vonë. "Çdo qytetar i Republikës është i barabartë. Rrugët e kontrabandës duhet të hetohen dhe të mbrohet integriteti territorial. Ky sistem i kamufluar si çështje humanitare jep indikacion se ka rrugë të kontrabandës në veri. Këto rrugë duhet të mbyllën. Çështjet humanitare janë udhërrëfyes yni, por duhet të bëhen rrugëve zyrtare si dy shtete. Nuk kemi qytetarë të kategorisë së parë ose të

dytë. Të gjithë jemi kosovarë dhe i obligohemi vetëm një Kushtetute e një ligji. Kemi sistem unitar të shtetit. Tendencat e Serbisë për ta rrezikuar këtë sistem, qoftë edhe në sistem shëndetësor, përbën cenim të integritetit tonë", ka thënë Selim Selimi, ministër i Drejtësisë.

Ndërkaq Qeveria e Kosovës përmes një komunikate për media ka theksuar se në bazë të informatave nga Dogana dhe nga Policia Kufitare, nuk ka të dhëna se në rrugë zyrtare në territorin e Kosovës kanë hyrë vaksinat kundër Covid-19, për të cilat është thënë se u janë shpërndarë qytetarëve në veri të vendit. "Nëse këto vakcina kanë hyrë në Kosovë përmes rrugëve ilegale, atëherë institucionet e Kosovës do t'i ndërmarrin masat e nevojshme ligjore ndaj personave të përfshirë në këtë aktivitet ilegal, kontrabandim me barëra. Përndryshe, institucionet e Kosovës nuk kanë pasur asnjë komunikim zyrtar me institucionet e Serbisë lidhur me këtë çështje, as të drejtpërdrejtë përmes zyrave ndërlidhëse të të dyja vendeve e as me ndërmjetësimin e bashkësisë ndërkombëtare", është thënë në komunikatën e qeverisë,

duke shtuar tutje se çdo produkt mjekësor që hyn në Republikën e Kosovës duhet t'u nënshtrohet rregullave të importit, qoftë ai donacion apo import i rregullt, duke pasur autorizim-marketing për produktin, të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Mjekësore. "Nëse një produkt nuk e respekton këtë procedurë të rregullt, ai konsiderohet produkt ilegal, ndërsa organet kompetente ndërmarrin veprimet e duhura ligjore", thuhet në këtë komunikatë. Të premtën presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se në veri të Kosovës ka filluar vaksinimi kundër koronavirusit me vaksinën "Pfizer/BioNTech", e cila ka arritur në Serbi para disa ditësh.

## Zemaj: Kosova ka aplikuar për vaksinë në COVAX

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se Kosova më 7 dhjetor ka aplikuar zyrtarisht në programin COVAX për sigurimin e vaksinës Covid-19. Në një konferencë për media në Prishtinë, Zemaj ka thënë se dozat fillimisht do të jenë të mjaftueshme për 20 për qind të popullsisë. COVAX është program i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i cili synon

shpërndarjen e vaksinës kundër Covid-19 edhe në vende më të varfra. Zemaj ka thënë kanë filluar kontaktet dhe negociatat edhe me kompani të tjera, por nuk saktësoi se cilat janë ato. "Duke ruajtur konfidencialitetin e kërkuar, nuk kemi mundur që në këtë fazë t'i paraqesim format ekzakte të negociimit dhe rrugëve të sigurimit të kësaj vaccine", është shprehur Zemaj.

## Deri më tani 1 309 të vdekur nga Covidi në Kosovë



**PRISHTINË, 27 DHJETOR (ER)** - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë janë testuar gjithsej 1 012 mostra të marra nga Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve kanë rezultuar 215 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar katër raste të vdekjes. Rastet e vdekjes janë nga komunat: Ferizaj dy raste

(70, 69 vjeç), Drenas një rast (52 vjeç) dhe Istog një rast (61 vjeç). Numri total i rasteve pozitive është 50 620 raste nga 179 402 persona të dyshimtë me këtë virus dhe 1 309 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 428 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 39 562 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 9 749.

Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 117 raste, Ferizaj 13 raste, Gjilan 11 raste, Prizren 10 raste, Lipjan 9 raste,

Mitrovicë 9 raste, Obiliq 7 raste, Fushë-Kosovë 6 raste, Pejë 4 raste, Gjakovë 3 raste, Podujevë 3 raste, Skenderaj 3 raste, Suharekë 3 raste, Viti 3 raste, Vushtrri 3 raste, Drenas 2 raste, Kamenicë 2 raste dhe me nga 1 rast komunat: Deçan, Hani i Elezit, Istog, Klinë, Malishevë, Novobërdë dhe Shtime. IKShPK-ja u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve që të vijnë të testohen për Covid sipas indikacioneve epidemiologjike, në të gjitha qendrat rajonale të shëndetësisë publike në Kosovë.



# Paqartësi rreth pozitës së presidentit



PRISHTINË, 27 DHJETOR - Vjosa Osmani, edhe pse mban zyrtarisht pozitën e ushtrueses së detyrës së presidentit të Kosovës, mund të garojë në zgjedhjet e jashtëzakonshme që pritet të mbahen së shpejti. Kjo gjë është përcaktuar para dhjetë vjetësh nga Gjykata Kushtetuese, në bazë të kërkesës së ushtruesit të atëhershëm të detyrës së presidentit, Jakup Krasniqi, i cili në atë kohë ishte edhe kryetar i Kuvendit dhe sekretar i përgjithshëm i Partisë Demokratike të Kosovës dhe synonte kandidimin në zgjedhje.

Ushtruesja e detyrës së presidentit ka thënë në intervistat e fundit në mediat e Kosovës se, “për dallim prej presidentit të zgjedhur, u. d. i presidentit ka të drejtë që të merret me politikë gjatë ushtrimit të funksionit. Pra, mund të garojë në zgjedhje, të mbajë pozicione etj.”. Vendimi i datës 22 dhjetor, 2010, i Gjykatës Kushtetuese, përcakton se “mbajtja dhe ushtrimi i këtyre dy funksioneve nga ushtruesi i detyrës së presidentit nuk përbëjnë shkelje të nenit 88.2 të Kushtetutës”, me arsyetimin se kufizimi, sipas këtij neni, vlen vetëm “pas zgjedhjes” së presidentit.

Andaj, Gjykata shpjegon se “presidenti i Republikës zgjidhet nga Kuvendi, ndërsa përgjegjësitë e ushtruesit të detyrës së presidentit rrjedhin nga Kushtetuta dhe,

rrjedhimisht, ushtruesi i detyrës së presidentit nuk kufizohet nga neni 88.2”. Gjykata ishte përgjigjur në pyetjen e parashtruar nga Krasniqi “nëse kufizimet e nenit 88.2 të Kushtetutës, sipas të cilit, presidenti, pas zgjedhjes, nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike, vlejnë edhe për ushtruesin e detyrës së presidentit”.

Pavarësisht prej këtij vendimi, analisti politik Ramush Tahiri vlerëson se Osmani nuk do të duhej “të ishte në listë zgjedhore, nën ndonjë lider politik cilido qoftë, kur flasim për zgjedhjet parlamentare”.

## Afatet ligjore për zgjedhjen e presidentit të ri

Në bazë të Kushtetutës, u. d. e presidentit të Republikës, Vjosa Osmani, mund ta ushtrojë detyrën deri më 5 maj 2021. Kjo pozitë ka mbetur e zbrazët më 5 nëntor, kur presidenti Hashim Thaçi ka dhënë dorëheqje për t’u përballur me akuzat për krime lufte në Hagë. Sipas analistit Ramush Tahiri, Kosova ka hyrë tashmë në afatet kushtetuese për zgjedhjen e presidentit të ri. “Bazuar në Kushtetutë, presidenti i ri i vendit duhet të zgjidhet më së largu dy muaj pas dorëheqjes së presidentit. Pra, i bie që Kuvendi është dashur që deri më 5 janar 2021 ta zgjedhë presidentin e ri. Tash janë krijuar edhe rrethana të reja

dhe vendi edhe ashtu po shkon në zgjedhje”, thotë Tahiri.

Ai vlerëson se po bëhen shumë keqinterpretime sa u përket afateve ligjore. “U. d. e presidentit e ushtron detyrën, nuk ka mandat. Kjo është e qartë në Kushtetutë. Te ne po e shpjegojnë se afati kushtetues është gjashtë muaj, por u. d. nuk ka mandat”, thotë Tahiri. “Është edhe afati tjetër që presidenti i ri të zgjidhet më së largu deri më 7 mars”, shton ai, duke aluduar në afatin njëmuajor para përfundimit të mandatit të presidentit të zgjedhur, Hashim Thaçi.

E gjithë kjo paqartësi sjell edhe dilemën se kush do ta drejtojë Kosovën pas 5 majit, nëse posti i presidentit mbetet sërish vakant - një situatë kjo e paprecedentë për Republikën që 12 vjet më parë ka shpallur pavarësinë.

Shumë vende me demokraci të zhvilluar e kanë të përcaktuar që, pos kryetarit të Kuvendit, pozita e presidentit, në kushte të jashtëzakonshme, mund të ushtrohet edhe nga kryetari/kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, por Kosova nuk e ka këtë dispozitë as në Kushtetutë dhe as në ligjet përkatëse. “Mungesa e presidentit sjell paqartësi se kush do ta dekretojë formimin e qeverisë, ose edhe kush do t’i shpallë zgjedhjet e reja”, thotë për “Radion Evropa e Lirë” analisti Fitim Salihu. “Kjo është situatë me shumë të panjohura, që kërkon maturitet të klasës politike”, shton ai.

## “Zgjedhjet të prodhojnë zgjidhje”

Kosova do të shkojë në zgjedhje parlamentare së shpejti, por njohësit e rrethanave politike nuk janë të bindur se zgjedhjet do të prodhojnë zgjidhje. “Personalisht, e parandiej se do të kemi një ngërç politik pas zgjedhjeve, sidomos pasi që, për herë të parë që nga zgjedhjet e vitit 2010, partia fituese duhet ta ketë mendjen te 80 vota dhe jo 61 vota. Mendoj se për hir të interesit nacional do të duhej të uleshin polarizimet, sepse është e palogjikshme që për dy muaj fushatë, t’i drejtosh të gjitha shigjetat ndaj kundërshtarëve dhe pastaj, brenda orës, ta ndërrosh qasjen dhe të shkosh t’iu kërkosh ndihmë për zgjedhjen e presidentit”, ka shtuar Salihu.

Por, Ramush Tahiri, pavarësisht se e konsideron “të papjekur klasën politike në vend”, pret që të arrihet konsensus paszgjedhor për presidentin. “Duke u nisur nga interesat e tyre partiake, mund të merren vesh për presidentin, por jo pse e ndiejnë përgjegjësinë për shtetin dhe tejkalimin e gjendjes, por për shkak se e llogaritin interesin e tyre për ndarjen e pushtetit”, thotë Tahiri.

Ai pret që zgjedhjet sërish të prodhojnë tri parti kryesore. “Do të kemi ndarje në dy blloqe. Por, do të kemi tri forca kryesore: Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës.

Është gati e pamundur që të arrijnë te 2/3 e votave për ta zgjedhur presidentin. Nëse LV-ja nuk bashkëpunon me PDK-në ose LDK-në, është e pamundur që të tejkalohet kjo situatë”, thotë Tahiri.

Edhe analisti Fitim Salihu e sheh të domosdoshëm bashkëpunimin e së paku dy partive shqiptare në Kuvend. “Jam shumë skeptik që një parti fituese do të marrë aq vota, duke i llogaritur edhe ulëset e minoriteteve sa ta zgjedhë e vetme presidentin me minoritete”, thotë Salihu.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë vijnë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës më 21 dhjetor, që vota e Etem Arifit, me rastin e votimit të Qeverisë së Avdullah Hotit, më 3 qershor, ishte e pavlefshme, pasi ndaj tij kishte një dënim të formës së prerë me mbi një vit burgim.

Në bazë të konstatimit të Gjykatës Kushtetuese, ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, duhet t’i shpallë zgjedhjet të cilat duhet të mbahen jo më vonë se 40 ditë nga dita e shpalljes së tyre.

Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Vjosa Osmani, tashmë i ka përfunduar konsultimet me partitë politike. Ajo ka njoftuar se vendimi për shpalljen e datës se kur do të mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare do të merret pas publikimit të vendimit të plotë të aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese.



# Ekonomia në Shqipëri ka rënë në 5.3 për qind

TIRANË, 27 DHJETOR (ER) - Ekonomia e Shqipërisë ka qëndruar në territor negativ edhe në tremujorin e tretë të këtij, ndonëse me ritme më të zbutura se në tremujorin e mëparshëm, kur i gjithë vendi ishte në izolim.

Të dhënat e publikuara nga Instat tregojnë se Produkti i Brendshëm Bruto (PBB), i ndikuar nga situata e krijuar nga Covid-19, në tremujorin e tretë të vitit 2020 vlerësohet me rënie prej 3.47-përqindësh kundrejt tremujorit të tretë të vitit 2019. Në tremujorin e dytë rënia ishte 10.2 për qind dhe në të parin - 2.52 për qind.

Për 9-mujorin, sipas të dhënave paraprake, ekonomia ka rënë mesatarisht me rreth 5.3 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Konsumi i dobët ka ndikuar në rënien e ekonomisë edhe në tremujorin e tretë, ndërsa dy sektorët që nuk po ndikohen fare nga kriza janë ndërtimi që ka ndikuar në 0.73 për qind të rritjes dhe pasuritë e paluajtshme (+0.53). Kjo e fundit shënoi rritje edhe në tremujorin e dytë të vitit, ndonëse vendi ishte në mbyllje totale. Të dhënat janë në një linjë me treguesit e hershëm të Instat për tregtinë me pakicë dhe volumet e aktivitetit të bizneseve, që tregonin se vetëm ndërtimi ishte pozitiv në tremujorin e tretë.


Edhe bujqësia, që ishte me ecuri

pozitive në tremujorin e dytë, ishte në stanjacion në të tretin. Në rritje ishte shëndetësia, duke reflektuar shpenzimet e shtuara për kujdes shëndetësor pas pandemisë.

Sipas Instat, në rënien e tremujorit të tretë negativisht kontribuuan aktivitetet: tregtia, transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor me -2,45 pikë përqindje; aktivitetet profesionale dhe shërbimet administrative me -1,20 pikë përqindje; aktivitetet e tjera shërbimi me -0,21 pikë përqindje; informacioni dhe komunikacioni me -0,07 pikë përqindje; aktivitetet financiare dhe të sigurimit me -0,03 pikë përqindje.

Kontribut pozitiv kanë dhënë degët: Ndërtimi me +0,73 pikë përqindje, aktivitetet e pasurive të paluajtshme me +0,53 pikë përqindje; administrata publike, arsimit dhe shëndetësia me +0,27 pikë përqindje; industria, energjia dhe uji me +0,10 pikë përqindje; dhe bujqësi, pyjet dhe peshkimi me +0,01 pikë përqindje. Taksat neto mbi produktet kontribuuan negativisht me -1,14 pikë përqindje.

Ndërtimi (+8.7) dhe pasuritë e paluajtshme (+9.54 për qind) janë dy sektorët që kanë shënuar rritjen më të lartë në krahasim me tremujorin e tretë të një viti më parë, duke qenë në tendencë të kundërt me ecurinë e gjithë ekonomisë dhe



konsumit të dobët. Sipas ekspertëve të pasurive të paluajtshme, rreth 60-70 për qind e blerjeve bëhen nga paratë informale, sidomos për apartamentet e shtrenjta, ndërsa ka edhe shumë firma pa histori financiare që po ndërtojnë.

Sipas Instat-it, degët kryesore të ekonomisë, për tremujorin e tretë të vitit 2020, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2019, shfaqen si më poshtë: Aktiviteti i bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit pati një rritje me 0,03 për qind. Aktiviteti i industrisë, energjisë dhe ujit pati një rritje me 0,78 për qind. Aktiviteti i ndërtimit pati një rritje me 8,72 për qind. Grupi i aktivitetëve tregti,

transport, akomodim dhe shërbim ushqimor pati një rënie prej 13,01 për qind. Grupi i aktivitetëve informacioni dhe komunikacioni u shfaq me rënie prej 2,38 për qind. Aktiviteti financiar dhe i sigurimit ka shënuar një rënie prej 0,73-përqindësh. Aktiviteti i pasurive të paluajtshme ka shënuar një rritje prej 9,54-përqindësh.

Grupi i aktivitetëve profesionale dhe shërbime administrative u shfaq me një rënie prej 16,63-përqindësh. Grupi i aktivitetëve të administratës publike, arsimit dhe shëndetësisë u shfaq me rritje prej 2,38-përqindësh.

Grupi i aktivitetëve arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitetet e tjera

shërbimi pati një rënie me 9,93 për qind. Taksat neto mbi produktet u ulën me 8,87 për qind.

Sa iu përket ndryshimeve në krahasim me tremujorin paraardhës, treguesi i Produktit të Brendshëm Bruto vlerësohet me rritje prej 9,77-përqindësh, ku rritjen më të madhe e shënuan aktivitetet financiare dhe të sigurimit me +31.64 për qind, të ndjekura nga industria nxjerrëse (+13.2 për qind).

Konsumi final i popullatës, i cili përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, u ul me 3,86 për qind, me bazë vjetore dhe u rrit me 6 për qind në krahasim me tremujorin e dytë.

## Ekonomia e Kinës do ta kapërcejë atë të ShBA-së

PEKIN, 27 DHJETOR - Kina do ta kapërcejë ShBA-në për t'u bërë ekonomia më e madhe në botë, deri në vitin 2028, parashikon një raport i ri.

Qendra për Kërkime Ekonomike dhe Biznesore, me seli në Mbretërinë e Bashkuar, vlerëson se menaxhimi "i aftë" i pandemisë Covid-19 në Kinë, do ta thellojë rritjen ekonomike në këtë vend, krahasuar me ShBA-në dhe Evropën.

Në raport, po ashtu, thuhet se India pritet të bëhet ekonomia e tretë deri në vitin 2030. Edhe pse Kina ka qenë vendi i parë që është goditur nga Covid-19, ajo e ka vënë sëmundjen shpejt nën kontroll, me veprime të shpejta dhe të rrepta, duke mos pasur nevojë t'i përsërisë izolimet ekonomike, siç kanë bërë disa vende të Evropës.

Si rezultat, ndryshe nga ekonomitë e tjera të mëdha, Kina ka shmangur recesionin

ekonomik në vitin 2020 dhe, madje, pritet të ketë rritje për 2 për qind këtë vit.

Ekonomia amerikane, në anën tjetër, është goditur rëndë nga pandemia sa iu përket shifrave. Mbi 18.5 milionë njerëz në ShBA janë prekur nga Covid-19, ndërsa mbi 330 000 kanë vdekur.

Dëmi ekonomik është zbutur me politika monetare dhe një stimul të madh fiskal, por mosmarrëveshjet politike mbi një paketë të re stimuluese mund të lënë rreth 14 milionë amerikanë të papunë pa pagesa nga shteti. "Për disa kohë, një temë kryesore e ekonomisë globale ka qenë lufta ekonomike midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës. Pandemia Covid-19 dhe pasojat përkatëse ekonomike e kanë çuar këtë rivalitet në favor të Kinës", thuhet në raportin e Qendrës për Kërkime Ekonomike dhe Biznesore me seli në Mbretërinë e Bashkuar.





# Sot pritet të votohet buxheti i Kosovës për vitin 2021

Sot (e hënë) do të mbahet seancë e jashtëzakonshme parlamentare, në të cilën do të jenë dy pika të rendit të ditës: votimi i Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe votimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

**EPOKA ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Votimi i Projektligjit për buxhetin e vitit 2021 të Kosovës pritet të bëhet të hënë, më 28 dhjetor, në një seancë të jashtëzakonshme parlamentare. Zyra për media e Kuvendit të Kosovës tha përmes një komunikate se dy pika të rendit të ditës janë të parapara për seancë: votimi i Projektligjit mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe votimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. Projektligji për buxhetin e vitit 2021 është dërguar në Kuvendin e Kosovës nga qeveria tashmë në largim dhe ndodhet në shqyrtim te Komisioni për buxhet dhe transfere. Kuvendi i Kosovës pritet të shpërndalet, pasi Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka shpallur javën e kaluar

jokushtetuese mënyrën se si është zgjedhur qeveria e udhëhequr nga Avdullah Hoti. Bashkimi Evropian dhe mekanizma të tjerë kanë bërë thirrje që të mos shpërndalet Kuvendi pa u miratuar buxheti.

Projektligji për buxhetin e vitit të ardhshëm kap vlerën e 2.4 miliardë eurove.

Në bazë të procedurave ligjore, afati përfundimtar kur duhet të miratohet Projektbuxheti për vitin 2021 nga deputetët e Kuvendit të Kosovës është data 31 dhjetor. Nëse buxheti nuk miratohet deri në këtë datë, në bazë të procedurave ligjore, Kuvendi, me anë të një vendimi, mund ta autorizojë vazhdimin e zbatimit të Ligjit për ndarjet buxhetore të vitit të kaluar fiskal. Ligji për ndarjet buxhetore i vitit të kaluar fiskal në asnjë rast nuk mund të vazhdojë të zbatohet për më gjatë se tre muaj të vitit të ardhshëm fiskal.



**Rukiqi bën thirrje që të votohet buxheti: Mosvotimi, skenar i dëmshëm për vendin**

Kryetari i Odës Ekonomike i Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, në një konferencë për media ka bërë thirrje se, para se të shkohet në zgjedhje të jashtëzakonshme, të votohet buxheti për vitin 2021, në të kundërtën thotë se do të jetë një skenar i dëmshëm për vendin dhe se nuk mund të

flitet për një rimëkëmbje ekonomike. "Në mënyrë që të shmanget bllokada e vendit ne bëjmë thirrje që deputetët të jenë të arsyeshëm për atë që ka dhënë hapësirë Gjykata Kushtetuese, që të mbajë një seancë dhe të miratojë buxhetin për vitin 2021, përkatësisht ndarjet buxhetore 2021. Nëse nuk ndodh kjo, jo që nuk mund të flasim për rimëkëmbje, por do të jetë skenari më i dëmshëm për vendin që nga paslufta për shkak se nuk ka

asnjë hapësirë ligjore dhe instrument financiar që do të mund ta mbajë funksional vendin dhe ta mbajë ekonominë në lëvizje. Prandaj është thirrje e komunitetit të bizneseve që kjo përbërje e Kuvendit në mesin e pak punëve të mira që ka bërë për ekonominë, së paku ta përmbyllë këtë vit dhe këtë mandat me një vendim të mirë dhe të mirëpritur për bizneset dhe qytetarët e vendit", ka theksuar Rukiqi.

## Diaspora nga paslufta ka dërguar mbi 40 miliardë euro në Kosovë

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Bashkatdhetarët tanë që nga viti 1999 e deri më tash llogaritet se kanë dërguar në Kosovë mbi 40 miliardë euro në mënyra të ndryshme. Ky kontribut i diasporës nga njohës të zhvillimeve ekonomike po vlerësohet mjaft i rëndësishëm për ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe social në Kosovë.

Sipas guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, vetëm sivjet remitencat nga bashkatdhetarët arrijnë rreth 800 milionë euro ose 13 për qind më shumë se në periudhën e vitit paraprak.

Eksperti i ekonomisë, Safet Gërxhaliu, thotë se diaspora ka qenë dhe vazhdon të mbetet shtylla kryesore e qëndrueshmërisë shtetërore e Kosovës. Veç kësaj, ai thotë se edhe vetë zanafilla e fillimit të luftës për Republikën fillon nga diaspora.

Më tej, Gërxhaliu ka thënë se në këtë fundvit diaspora ka arritur trefishin e rëndësisë së Pakos Emergjente në Kosovë. "Vetëm

qëndrimi i afër 100 mijë mërgimtarëve në Kosovë në festat e fundvitit e ka të paktën trefishin e rëndësisë që ka një pako emergjente e miratuar me vonesë, e politizuar, e amortizuar çfarë ka qenë ajo në Kuvendin e Kosovës e

propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës", ka theksuar ai.

Guvernatori Mehmeti ka theksuar se remitencat nga diaspora në këtë kohë të vështirë pandemike vazhduan rrjedhën e saj, ku deri në tetor

2020 kanë shënuar 796.5 milionë euro, me një rritje vjetore 12.9 për qind. "Një faktor që ka ndikuar në zbutjen e efekteve të krizës kanë qenë remitencat nga diaspora, të cilat në këtë kohë shumë të vështirë për ekonominë

botërore vazhduan rrjedhën e vazhdueshme drejt ekonomisë tonë. Vlera e remitencave të pranuar deri në tetor 2020 ishte 796.5 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 12.9-përqindësh", ka thënë Mehmeti.





## Heroizmi i familjes Jashari, temë diplome në gjimnazin zviceran

Skenderaj, 27 dhjetor (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka pritur në takim Elmedina Buja, bashkë me nënën e saj, e cila heroizmin e familjes Jashari kishte vendosur ta marrë temë diplomë në gjimnazin e Bazelit në Zvicër. Elmedina së bashku me

nënën dhe bashkëpunëtorin e saj e njoftuan kryetarin Jashari se për këtë temë diplome ajo kishte hulumtuar duke intervistuar edhe Besartën dhe dëshmitarë tjetër të luftës sonë të lavdishme. Jashari tha se përmes këtij hulumtimi Elmedina njoftoi shoqërinë zvicerane për luftën

dhe rezistencën e familjes Jashari si dhe të familjeve të tjera. “Ambasadorët e tyre në Kosovë si dhe të familjeve në shtetet perëndimore si Elmedina Buja i nevojiten Kosovës në mënyrë që të vijet në pah pastërtia e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, ka thënë kryetari Jashari.



## AAK-së në Rahovec i bashkohen disa të rinj



Rahovec, 27 dhjetor (ER) - Kryetari i Degës së AAK-së në Rahovec, Smajl Latifi, ka bërë me dije se këtij subjekti politik i janë bashkuar disa të rinj, profesionistë të fushave të ndryshme. “Kënaqësi e veçantë t’u uroj mirëseardhje në AAK, Elbunitit, Valonit,

Bajramit, Ardianit dhe Albinit, të cilët besojnë në programin e AAK-së dhe në udhëheqjen e saj të vendosur dhe zbatues, gjithashtu aty ku ata shohin garanci për krijimin e kushteve për të rinjtë e Kosovës, ta ndërtojnë jetën e re dhe karrierën e tyre

profesionale në vend”, ka shkruar Latifi në llogarinë e vet në “Facebook”. Ai ka thënë se është dëshmi se njerëzit e devotshëm të Kosovës duan t’i shërbejnë forcimit të shtetit dhe mbrojtjes së sovranitetit të tij dhe jo politikave ditore.

## Ekipe të emergjencës dhe zjarrfikësit intervenojnë në disa gypa atmosferikë në Drenas dhe Komoran

DRENAS, 27 DHJETOR (ER) - Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë ka dalë në terren për monitorim të gjendjes pas të reshurave të shiut. Drejtoresha e DShP-së, Lumnije Krapit, ka njoftuar se ekipet e emergjencës dhe shërbimi i zjarrfikësve kanë

intervenuar në disa gypa atmosferikë në Drenas dhe Komoran. Ekipet e Komunës së Drenasit çdoherë janë të gatshme për intervenime. Këto ekipe të komunës kanë ftuar qytetarët të jenë bashkëpunues në situatat e tilla.



## Bulliqi, dëshmitar në kurorëzimin e një çifti të ri

PODUJEVË, 27 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka qenë dëshmitar në kurorëzimin e çiftit të ri Erëza Rekalit dhe Endrit Salihi që u bë në Komunën e Podujevës. Kryetari Bulliqi falënderoi çiftin e ri që kishin përzgjedhur që ai të jetë dëshmitar në aktin më solemn dhe më të rëndësishëm të kurorëzimit të një martese. Kryetari Bulliqi e uroi çiftin e ri

duke i dëshiruar lumturi dhe harmoni në jetën bashkëshortore. Kurorëzimi i këtij çifti u bë në fundjavë, duke pasur parasysh se kryetari Bulliqi ka marrë vendim që sektori i shërbimeve me qytetarë në administratën komunale të punojë edhe gjatë ditëve të fundjavës për shkak të rritjes së vëllimit të punëve dhe kërkesave me rastin e ardhjes së bashkatdhetarëve për festat e fundvitit.



## Komuna e Prizrenit shpërndan mjete dezinfektuese dhe higjienike për shkollat

Prizren, 27 dhjetor (ER) - Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren ka vazhduar shpërndarjen e mjeteve

dezinfektuese dhe higjienike për të gjitha shkollat e Prizrenit, makina për spërkatje, maska mbrojtëse,

DimerSept-10, dezinfektues për duar dhe mjete të tjera higjienike për mbrojtje nga Covid-19. “Mbrojtja e

shëndetit të nxënësve dhe mësimit është prioritet”, ka njoftuar Komuna e Prizrenit.





# KOSOVA NË MES TË OLIGARKISË DHE DEMOKRACISË SË BRENDSHME

Nëse i referohemi një studiuesi tashmë klasik të partive politike, Robert Michels, i cili pohon se mungesa e demokracisë së brendshme partiake çon detyrimisht në oligarki, atëherë nuk e kemi vështirë të konstatojmë se një pjesë e formacioneve tona politike po shkojnë drejt oligarkisë, duke përjashtuar energjitë e reja me njerëz e ide që mund ta sjellin ndryshimin. Zgjedhjet e ardhshme duhet të provojnë në praktikë bilancin e betejave politike në mes të oligarkive partiake dhe demokracisë së brendshme, duke nxjerr si produkt final një skenë politike të liruar nga recidivat e së kaluarës me personazhe që mbijetesën politike e ndërtonin mbi gërmadhat e rrënuara të së ardhmes



**Nga Mehmet PRISHTINA**

Zgjedhjet e reja në Kosovë duhet të mbahen shpejt, pasi që Gjykata Kushtetuese gjeti që Qeveria e udhëhequr nga Avdullah Hoti, ishte zgjedhur në mënyrë antikushtetuese me, kur një deputet i dënuar për korrupsion nuk kishte pasur të drejtë të votojë, e në fakt kjo votë ishte vendimtare për miratimin e qeverisë në Kuvend prej 61 votash.

Sipas Kushtetutës, zgjedhjet duhet të mbahen jo më larg se 40 ditë pas shpalljes së tyre. "Jemi në dijeni për vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe tani u takon institucioneve të Kosovës që t'i bëjnë hapat e ardhshëm përkatës, në përputhje me vendimin. BE do të vazhdojë të angazhohet me të gjithë në Kosovë, për të promovuar agjendën e integriteteve evropiane dhe reformat e nevojshme. Në këtë fazë është posaçërisht e rëndësishme që buxheti për vitin 2021 të miratohet dhe kalohet nga kjo përbërje e Kuvendit, sa më parë që të jetë e mundur", tha njëri nga zëdhënësit e BE-së, Peter Stano.

Pra, tani për tani Kosova ndodhet para dy sfidave. E

para, që lidhet me miratimin e buxhetit 2021 dhe e dyta - mbajtja e zgjedhjeve sipas rekomandimit të Gjykatës Kushtetuese.

Siç është njoftuar edhe nga mediat, tashmë projektligji për buxhetin e vitit 2021 është dërguar në Kuvendin e Kosovës nga ana e Qeverisë në largim dhe ky projektbuxhet ndodhet në shqyrtim në Komisionin për buxhet dhe transfere.

Ndërkohë kryeministri Avdullah Hoti, është shprehur se muaji janar nuk duhet ta gjejë Kosovën pa buxhet të miratuar për vitin 2021. Sipas tij "buxheti për vitin tjetër është i përgatitur mirë", dhe kërkoi nga partitë politike në Kuvend "që të bëjnë propozimet për ndryshimet e mundshme", për çka i ftoi që ta votojnë buxhetin. Data e mbajtjes së zgjedhjeve do të mund të caktohet pasi që Gjykata Kushtetuese del me aktgjykimin e plotë mbi votimin e Qeverisë së Kosovës më 3 qershor. Ende nuk dihet saktësisht se kur do të mbahen zgjedhjet, por përfaqësuesit e ndryshëm të partitë politike kanë përmendur fundin e muajit janar dhe fillimin e shkurtit të vitit 2021, si periudha të mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve.

Që nga mbarimi i luftës (1999), Kosova mban rekord sa i përket numrit të kryeministrave, duke pasur deri më tani tetë, në dhjetë

mandate të papërfunduara.

Kur jemi te rekordet të përmendim edhe një tjetër që lidhet me ushtruesit e detyrave. Kosova kurrë nuk ka pasur më shumë ushtrues detyre në pozita udhëheqëse në këtë periudhë njëzet vjeçare.

Sipas Kodit për Praktikë të Mirë të Komisionit të Venecias (Këshilli i Evropës) partitë politike përkufizohen si asociacione jofitimprurëse të personave që marrin pushtetin nga përfaqësuesit e tyre të zgjedhur dhe e ushtrojnë atë për të mirën e përgjithshme. Ky Kod thekson se partitë politike luajnë dy role thelbësore në demokracinë përfaqësuese: një rol shoqëror, duke kontribuar në socializimin politik të qytetarëve dhe artikulimin e pluralizmit ideologjik të tyre, dhe një rol institucional, duke e kontrolluar qeverinë dhe duke prezantuar politika dhe kandidatë alternativë.

Nëse i referohemi një studiues tashmë klasik të partive politike, Robert Michels, i cili pohon se mungesa e demokracisë së brendshme partiake çon detyrimisht në oligarki, atëherë nuk e kemi vështirë të konstatojmë se një pjesë e formacioneve tona politike po shkojnë drejt oligarkisë, duke përjashtuar energjitë e reja me njerëz e ide që mund të sjellin ndryshimin. Kjo temë imponohet për debat

edhe njëherë kur Kosova, pas shumë cikleve zgjedhore dhe pas shumë mandateve të papërfunduara qeveritare, do të duhej të ballafaqohet me garën elektorale të radhës, ku votuesit do të duhej të zgjedhin në mes të oligarkëve politikë dhe reformatorëve demokratë.

Teoritë e ndryshme mbi demokracinë shumë qartë i përkufizojnë fushat ku zhvillohen idetë politike me afinitete avangarde dhe retrograde. Zgjedhësi ynë në Kosovë viteve të fundit ka treguar një sens më të zhvilluar për të detektuar bartësit e ideve që mund të sjellin ndryshime, duke u shfaqur më të rezervuar ndaj opsioneve e fytyrave të konsumuara të politikës publike. Është në logjikën e gjërave që ky diskurs elektorale të thellohet më tej edhe në zgjedhjet parlamentare të radhës, sepse sa më e rafinuar të jetë shija seleksionuese e votuesve, aq më të pastër do ta kemi ekologjinë politike në Kosovë.

Zgjedhjet e ardhshme duhet të provojnë në praktikë bilancin e betejave politike në mes të oligarkive partiake dhe demokracisë së brendshme, duke nxjerr si produkt final një skenë politike të liruar nga recidivat e së kaluarës me personazhe që mbijetesën politike e ndërtonin mbi gërmadhat e rrënuara të së ardhmes.

## FJALËN, FJALËN E KEMI SE NA E DHA ZOTI, MYSLIMAN APO I KRISHTERË: KOSOVA ËSHTË SHQIPËRI!



**Denion NDRENIKA**

Ardhmëria e krahinës më të rëndësishme të Shqipërisë Verilindore që i thonë Kosovë është në pikëpyetje nëse ata që u përpoqën të fshihen pas ndërkombëtarëve, për ndalimin e një shteti tonë të

vetëm, nuk e mbrojnë dot si të këtyllë. Ne shqiptarët e kuptojmë që pavarësimi i kësaj pjese të Shqipërisë mund të jetë një hap i vogël dhe i ngadaltë në ecjen drejt rikthimit të saj në kufijtë e të vetmit shtet të shqiptarëve të bashkuar sikurse vendosën Prizreni dhe Vlora më 1878 dhe 1912. Mirëpo kjo kujtesë e vockël nuk është për këtë ecje, por për ata që përpiqen rëndomë pa tekst qartësues dhe bindës që ta formësojnë shtetësinë. Thjesht, harrojeni, Kosova është pjesë e Shqipërisë e kësajsoj cilido edepsëz apo

fatkeq e qyqar me apo pa bindje, me apo dashje argumente ose jo, sido që ta diskutojë, është i humbur.


Ne nuk kemi fuqi, mbase! Nuk ndryshojmë dot asgjë, ndoshta! Me apo poezi apo shkrime e libra. Por, fjalën, fjalën e kemi se na e dha Zoti, qoftë mysliman apo i krishterë. Kosova është Shqipëri. Prandaj i përbuz dhe i nënçmoj zabërhanët që na sajojnë gjuhë e simbole të ndryshme. Madje, edhe nëse fshihen si burracakë pas ndërkombëtarëve që, kinse, nuk na lënë e na pengojnë, sepse në qoftë kështu, ta

pranojë ballëhapur që kjo është arsyeja, e jo ta mbrojnë si zhvillim normal, është zhvillim i detyruar dhe këtë e kuptoj, por jo justifikimin!

Mora shkas për këtë postim nga fort i nderuari prof. mr. Eroll Sejdiu në grupin "Gjuha standarde shqipe". Sejdiu qartësisht dhe qetësisht shpjegon se çka na ka ndodhur ne shqiptarëve, për t'ua kundërvënë po kaq butësisht kundërshtuese fatkeq se, kinse, shqipja standarde na paska dëmtuar e penguar. Enver Hoxha është kurrkushi për ta ndryshuar

shqiptarizmen, madje e ka vlarë atë me krimet e panumërta në Shqipërinë londineze. Mirëpo gjuha është e njëjta për ne dhe ky soj i padashur njerëzisht mjeranë nuk e ndryshon dot me kurrfarë justifikimi. Lërimi Enver kriminelin dhe merruni me shqipen. A jemi të njëjtët që e flasim apo disa edepsëzë na e sajojnë si dialekt apo kombformim e shtetformim mjeran. Kurrkush nuk e ndryshon dot qenien e Kosovës pjesë e Shqipërisë e kësajsoj shqipen që e flasim të tanë gjithkund!





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Bashkimi mundi Pejën



**PRIZREN, 27 DHJETOR** - KB Bashkimi ka mundur KB Pejën me rezultat 92:83 (19:33, 25:11, 27:6, 21:23), në kuadër të xhiros së 11-të në Prince Caffè Superligën e Kosovës në basketboll. Pejanët dominuan në çerekun e parë, duke e fituar këtë pjesë 19:33. Por, vendësit nuk u dorëzuan dhe dalëngadalë u rikthyen. Prizrenasit fituan periudhën e dytë 25:21, duke shkuar në pushim me shifrat 44:54. Rikthimi i madh i Bashkimit ndodhi në periodën e tretë, duke qenë dominues ndaj pejanëve, 27:6, kurse rezultati në semafor pas 30-minutash ishte 71:60. Në 10 minutat e fundit u zhvillua lojë e barabartë dhe Bashkimi triumfoi në fund me rezultat 92:83. Te Bashkimi u dalluan

Sean Hoehn me 22 pikë, Shaq Carter me 22 pikë e 13 kërcime, Julian Hamati me 18 pikë e 13 kërcime dhe Musab Mala me 21 pikë e gjashtë asistime, kurse te Peja më i miri ishte Dion Dixon me 31 pikë, kurse munguan dyshja Dardan Berisha dhe Drilon Hajrizi. Bashkimi ka gjashtë fitore dhe pesë humbje, kurse Peja shtatë fitore dhe katër humbje.

Të shtunën Vëllaznimi ka shënuar fitore ndaj Trepçës në udhëtim 86:91 (22:22, 15:26, 17:16, 32:27). Te Trepça u dalluan Tramaine Isabell me 25 pikë, 6 kërcime e shtatë asistime dhe Mojeed Ewuosho me 21 pikë, kurse te Vëllaznimi u dalluan Cendrik Council me 30 pikë e 14 kërcime dhe Christopher

Hortman me 25 pikë, 9 kërcime e 9 asistime. Golden Eagle Ylli ka gjashtë fitore dhe pesë humbje, kurse Sigal Prishtina tri fitore dhe tetë humbje. Ndërsa në ndeshjen tjetër Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore ndaj Sigal Prishtinës 78:73 (12:17, 20:18, 22:19, 24:19). Te Golden Eagle Ylli u dalluan Cody John me 16 pikë e pesë asistime, Demetris Morant me 12 pikë e 12 kërcime, Samir Zekiqi me 13 pikë dhe Valon Bunjaku dhe Egzon Kuqi me nga 12 pikë, kurse te Sigal Prishtina u dalluan Fisnik Rugova dhe Edmond Azemi me 19, përkatësisht 17 pikë. Golden Eagle Ylli ka gjashtë fitore dhe pesë humbje, kurse Sigal Prishtina tri fitore dhe tetë humbje.

### SHKURT

#### Lazio e rikthen Muriqin në Fenerbahçe

Aventura e Vedat Muriqit te Lazio nuk ka shkuar ashtu siç pritej. Në ndeshjet e fundit ka qenë në qendër të kritikave për paraqitjet e tij. Në këtë situatë, Lazio ka marrë vendim ta largojë sulmuesin në afatin kalimtar të janarit. Mediat turke e bëjnë të sigurt se Muriqi do të rikthehet te Fenerbahçe në formën e huazimit për 6 muaj. Futbollisti nga Kosova është pajtuar për rikthimin te Fenerbahçe, e cila do të paguajë 1.3 milion euro, gjysmën e pagës së futbollistit deri në qershor. Muriqi do të luajë me Fenerbahçen deri në fund të sezonit, për t'u rikthyer pastaj përsëri te Lazio, ku shpreson që të jetë në formën më të mirë dhe t'i bindë drejtuesit.

#### Ndërroi jetë rekordmeni shqiptar i notit

Një lajm tragjik vjen nga Amerika. Ka ndërruar jetë në moshën 24-vjeçare rekordmeni shqiptar i notit, Klavio Meça. Ai shihej si e ardhmja e këtij sporti në vendin tonë. Ende nuk dihen shkaqet e vdekjes së të riut nga Fushë-Kruja por, sipas informacioneve të para, dyshohet për një sulm në zemër. Meça mbante rekordin kombëtar në 400 m stil i lirë (4'04"03), të vendosur në Kampionatin Botëror të mbajtur në Budapest të Hungarisë.

#### Përforcohet KB Trepça

KB Trepça po vazhdon ndryshimet në ekip pas transferimeve të mëparshme dhe ndërrimit të trajnerit, tani klubi mitrovicas e ka zyrtarizuar edhe një basketbollist të ri. Fjala është për Staphon Blair. 27-vjeçari u transferua nga ekipi Fukushima. Amerikani regjistroi një mesatare prej 11.2 pikësh, 9 kërcime dhe 0.8 asistime për Fukushiman. "Pas rezultateve jo të pritshme deri me tani dhe pas ndërrimit të kryetrajnerit, KB Trepça ka nënshkruar me lojtarin e pozitës qendër, Staphon Blair", thuhet në njoftimin e KB Trepça.

#### Portlandi fitoi dramën ndaj Houstonit

Ndeshja Portland Trail Blazers - Houston Rockets ka dhënë fituesin vetëm pas vazhdimeve. Koha e rregullt ka përfunduar me rezultat të barabartë 113:113, teksa pas vazhdimeve Blazers triumfoi me dy pikë epërsi 128:126. Rocketsi ishte duke triumfuar, por gjashtë sekonda para fundit të ndeshjes CJ McCollum shënoi një trepikësh për t'ia siguruar fitoren skuadrës së tij. CJ McCollum ishte basketbollisti më efikas në këtë takim për vendasit me 44 pikë, tri kërcime e tetë asistime. Me lojë të mirë te skuadra fituese u dallua edhe Damien Lillard me 32 pikë e nëntë asistime si dhe Jusuf Nurkiç që shtoi 12 pikë e 11 kërcime. Te skuadra mysafire James Hardeni shënoi 44 pikë, por që nuk mjaftuan për fitoren e ekipit të tij. Rezultatet: Charlotte Hornets - Oklahoma City Thunder (107-109), Detroit Pistons - Cleveland Cavaliers (119-128), Washington Wizards - Orlando Magic (120-130), New York Knick - Philadelphia 76ers (89-109), Chicago Bulls - Indiana Pacers (106-125), San Antonio Spurs - Toronto Raptors (119-114), Utah Jazz - Minnesota Timberwolves (111-116), Portland Trail Blazers - Houston Rockets (128-126), Sacramento Kings - Phoenix Suns (106-103).

## Gara e Turqisë zgjedhet më e bukura e këtij sezoni në Formula 1

Stamboll, 27 dhjetor - Fansat e Formula 1 kanë bërë zgjedhjen e tyre. Gara e Çmimit të Madh të Turqisë, zhvilluar më 15 nëntor në Stamboll, ka qenë gara më e bukur e këtij viti në Formula 1. Rikuperimi i Hamiltonit, që triumfoi me makinën e tij

Mercedes, podiumi i vetëm sezonal i Sebastian Vettelit, që kaloi shokun e tij të skuadrës në kthesën e fundit, apo edhe mbrojtja e mirë që Sergio Perez bëri ndaj sulmeve të Max Verstappenit, kanë bërë që fansat ta zgjedhin garën e

zhvilluar në Stamboll si më të bukurën. 33 % e fansave kanë votuar për këtë garë, ndërsa në vendin e dytë u klasifikua gara e zhvilluar në Itali, me 25 % të votave. Gara e tretë më e bukur është ajo e zhvilluar në Sakhir, me 18 % të votave.





## Xhaka: Jam krenar me ekipin tim

LONDËR, 27 DHJETOR - Mesfushori i Arsenalit, Granit Xhaka, ka thënë se ndihet i lumtur me fitoren e ekipit të tij kundër Chelseat. Ai pas ndeshjes ka shkruar në "Facebook" në gjuhën angleze

se ndonjëherë veprat flasin më shumë se fjalët. "Ndonjëherë veprimet flasin më shumë se fjalët. Krenar me ekipin tonë sonte", ka shkruar Xhaka. Ai kontribuoi në fitoren e Arsenalit përmes një goli nga

gjuajtja e lirë në minutën e 44-t. Fjalë të mira për ndeshjen ka pasur edhe trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta. Ai ka deklaruar se ekipi kishte energji dhe ishte i gatshëm për ta fituar ndeshjen. "Fryma para ndeshjes ishte me

të vërtetë pozitive. Ata e donin atë. Unë jam i kënaqur për lojtarët dhe për tifozët. Ne i kemi lënë ata për shumë javë kështu që ishte një ditë e mirë t'u jepja atyre diçka për të festuar", ka thënë Arteta.



## Sokoli: Gjilani synon njërin nga tri pozitat e para

GJILAN, 27 DHJETOR - Trajneri i ri i skuadrës së Gjilanit, Bylbyl Sokoli, e ka bërë të qartë se skuadra që ai drejton është shumë e vendosur që në këtë edicion garues të Superligës së Kosovës, të renditet në dy-tre vendet e para. Sokoli debutoi me një fitore të thellë prej 4-0, ndaj skuadrës së Ballkanit në Suharekë dhe kjo i ka dhënë kurajë dhe besim trajnerit për të synuar diçka më shumë. Sokoli në një intervistë për "KosovaPress", ka thënë se skuadra që ai drejton ka udhëheqësi të shkëlqyeshme në të gjitha aspektet dhe se aty ku ka kushte, rezultatet nuk do të mungojnë. "Kosova është në ngritje e sipër të cilësisë. Kosova edhe e ka përmirësuar mjaft infrastrukturën e që ende nuk është e mjaftueshme kjo, nevojitet shumë më tepër, por është shumë e qartë që ekipi ynë, gjegjësisht kampionati ynë ka shënuar ngritje e sipër edhe përkundër pandemisë", ka thënë Sokoli, duke shtuar: "Ekipet tona kanë bërë transfere shumë të shtrenjta në këtë afat kalimtar dhe kanë krijuar një konkurrencë shumë të fortë brenda për brenda klubeve. Unë pres që të ketë edhe më shumë investime, edhe më shumë mobilizim... që kur të dalim në Evropë të kalojmë bile dy, tri xhiro sepse është e



nevojshme". Trajneri bylbyl Sokoli ka folur edhe për Përfaqësuesen e Kosovës. Ai ka thënë se "dardanët" kanë një grup të vështirë, por mund të marrin rezultate pozitive. "Është vështirë të parashikohet ajo renditja tabelore, por ne e dimë që nuk kemi luajtur me Spanjën dhe me Suedinë, kurse me Greqinë kemi zhvilluar gara. Unë po them kundër Spanjës dhe Suedisë do të kemi një ballafaqim i cili nuk na favorizon shumë, por jam i sigurt që nëse Përfaqësuesja e Kosovës vjen me të gjithë futbollistët që janë në formë më të mirë dhe të gjithë futbollistët të cilët luajnë në ekipet më të mëdha siç është Rrahmani, Muriqi, Rashica, unë mendoj se do të kemi ekip i cili do të ketë,

do të na japë shpresa për ndonjë rezultat të favorshëm, por duhet pranuar se këto ekipe sidomos Spanja, Suedia edhe Greqia janë në ranglistë shumë më lart se që është Kosova", ka shtuar Sokoli. "Janë ekipe shumë cilësore, janë ekipe të cilët kanë në mesin e tyre futbollistë të shquar nëpër shumë klube me nam, prandaj janë favoritë, por ne në këtë pjesë duhet kërkuar prezantim ndeshje pas ndeshje, jo të mendojmë për Greqinë para se të luajmë me Greqinë, jo të mendojmë për Spanjën derisa luajmë me Greqinë e kështu me radhë, por kjo nuk ka ndodhur sepse kemi përzgjedhës me përvojë dhe kam bindjen se ekipi ynë do të dijë të mobilizohet ndaj këtyre kundërshtarëve të fuqishëm", ka pohuar Sokoli.

## Thaqi: Ky ekip i Ballkanit është ndërtuar për të arritur suksese të mëdha

SUHAREKË, 27 DHJETOR - Armend Thaqi pranoi çmimin e lojtarit më të mirë të Superligës për vitin 2020 në ceremoninë e "Laureatëve të Vitit" të organizuar nga Federata e Futbollit e Kosovës. Mbrojtësi i krahut ishte spektakolar gjatë vitit që lëmë pas duke arritur të kontribuojë në 27 prej golave të skuadrave të tij, Ballkanit dhe Prishtinës. Ai gjatë këtij viti shënoi 6 herë dhe asistoi në plot 21 raste. Në një bisedë për "Gazetën Olle", Thaqi tregon synimet e tij dhe të skuadrës për vitin 2021. "Synimet janë që të kemi paraqitje sa më të mira dhe t'i ndihmojmë ekipit gjatë gjithë kohës me potencialin tim të plotë", ka thënë Thaqi. "Evropën e kërkojmë në bazë të asaj që tregojmë në fushë dhe normalisht pasi që dihet se



skuadra është krijuar dhe ndërtuar për të arritur suksese sa më të mëdha. Gjithmonë ka hapësirë për përmirësime dhe gjithmonë mundohem të jap më të mirën për të vazhduar me rezultatet e mira dhe për të mbajtur ritmin e paraqitjeve

pozitive, normalisht që synoj të bëjë akoma më mirë si në fazën ofensive edhe në atë defensive", ka shtuar Thaqi. Suharekasit për momentin gjenden në pushime, teksa skuadra do të bëjë edhe një mini-revolucion që ka filluar me shkarkimin e Ismet Munishit.

### SHKURT

#### Roma në janar bën ofertë zyrtare për Hysajn

AS Roma premtion të jetë një nga ekipet më aktive në këtë afatin kalimtar të dimrit, me dy objektiva të qarta, Milik dhe Hysaj. Emri i Hysajt nuk është një risi në shtëpinë e verdhekuqeve, e kërkuar edhe gjatë merkatos së verës, madje kapiteni dhe kryeqytetasit kishin gjetur një pajtim paraprak përpara se të merrnin një "jo" të prerë nga Napoli. Në javët e fundit, Napoli, i shtyrë dhe nga trajneri Rino Gattuso, është përpjekur të bindë anësozin kuqezi, por oferta e tyre ekonomike nuk ka kënaqur Hysajn, duke bërë që tashmë Napoli të mos jetë më në pozita të favorshme, pasi në fund të sezonit rrezikojnë ta humbasin me parametra zero. Roma nuk dëshiron të presë më gjatë dhe në janar pritet t'i ofrojë Napolit një ofertë të re për Hysajn. Fonseca e kërkon me çdo kusht dhe sa më shpejt, por të negociosh me De Laurentiis nuk është aspak e lehtë.

#### Juve, afër transferimit të Llorentes dhe Ozilit

Drejtuuesit e Juventusit janë duke planifikuar që të përforcohen në afatin kalimtar të janarit. Sipas mediave italiane, "Zonja e Vjetër" është duke planifikuar rikthimin e sulmuesit Fernando Llorente, i cili ishte pjesë e kësaj skuadre nga viti 2015 deri në vitin 2018. Sulmuesi e njëj mirë ambientin dhe pa problem e pranon edhe rolin e rezervistit. Emri tjetër që po qarkullon ditët e fundit është ai i mesfushorit Mesut Ozil. Ky i fundit nuk po ka hapësirë në skuadrën e Arsenalit dhe do të largohet në janar.

#### Messi: Guardiola dhe Enrique janë më të mirët

Zbulohen detaje të reja të intervistës së Leo Messit me gazetarin Jordi Evole në "La Sexta". Argentinasi ka treguar në këtë rast se kush janë trajnerët më të mirë që ka pasur gjatë gjithë karrierës së tij. Ata janë Pep Guardiola dhe Luis Enrique. "Pep ka diçka të veçantë. Ai të bën t'i shohësh gjërat në mënyrë... si i përgatit ndeshjet, në aspektin mbrojtës, si të sulmosh... ta shoshte saktësisht se ku ishte loja, si duhej të sulmonim për të fituar. Unë isha 'i pafat', në thonjëza, sepse kisha punuar për shumë kohë me Guardiolen dhe Luis Enriquen, dy më të mirët. Puna e gjatë me ta më bëri të rritem shumë në futboll dhe në mençurinë taktike që ata më mësuajnë".

#### Lorenzo: Dovizioso është ziliqar, e kam mposhtur gjithmonë

Nuk mund të jenë miq kurrë, madje as për Krishtlindje. Ndodh përplasja e radhës midis Andrea Doviziosos dhe Jorge Lorenzos përmes mediave sociale. Piloti nga Mallorca, në fakt, u përgjigj në "Instagram" për fjalët e italianit: "Ai ka qenë ziliqar për mua që nga kohët e 250. Të dy e dimë se është një urrejti që nuk ka lindur te Ducati, por kur unë pranova ofertën e Ducatit doja t'i jepja marrëdhënies sonë një mundësi". Numri 99 e rrit dozën e inatit ndaj italianit: "Në sezonin e parë si shokë të Ducatit shkova ta komplimentoja nën podium, por në këmbim kam marrë vetëm fjalë negative nga ai, edhe kur m'u desh të tërhiqesha për shkak të një problemi mekanik. E kuptoj shumë mirë që është lënduar nga fakti që Ducati vendosi të vinte bast për një kampion dhe t'i jepte një pagë 12 herë më të lartë, por realiteti është që e kam mposhtur në 250-kubikësh dhe nëntë vjet të MotoGP". Gjithçka nisi me një intervistë të fundit të Doviziosos me Dazn në të cilën ka thënë: "Unë nuk e kuptoj se çfarë problemi ka Jorge me mua: ai vazhdon të më sulmojë në intervista, edhe nëse në dy vjetët e fundit ai gjithmonë ka përfunduar pas meje".



Rrallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kieślowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

**Zymer Kelmendi**

\*\*\*

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kieślowski, i ndërthurur me një egzekjez të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

**Kristë Shtufi**

\*\*\*

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

**Fadil Sahiti**

\*\*\*

... përmes mikrobotës së Kieślowskit, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

**Orhan Kerkezi**

\*\*\*

Kur shikohet "Dekalogu" i Kieślowskit dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

**Daut Dauti**



ÇMIMI: 5.99 €


AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚLÓWSKI



AGRON SHALA

DEKALOGU

[nga Moisiu deri te Kieślowski]



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studiuës i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

*Një palë këpucë në Berlin* është novela e tij e parë.



4.99 €

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

Daut Dauti  
NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë











## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

